



Informatë për shtyp - 291/04/2020

22.04.2020
faqe 1 nga 2

Nordrhein-Westfalen, Niedersachsen, Rheinland-Pfalz dhe Saarland vendosin për përdorimin e maskave

Zyra e Shtypit të Kancelarisë
Shtetërore
40213 Düsseldorf
Telefon 0211 837-1134
0211 837-1405
oder 0211 837-1151

presse@stk.nrw.de
www.land.nrw

Mbulimi i gojës dhe hundës prej 27 prillit në trafikun publik dhe në dyqane - Laschet: Ne duhet të bëjmë gjithçka, që ndihmon për të gjetur rrugën në kthimin e jetës normale.

Deklaratat e zëdhënësve të Qeverive të Nordrhein-Westfalen, të Niedersachsen, të Rheinland-Pfalz dhe të Saarland:

Sipas pikëpamjes së Qeverive të Nordrhein-Westfalen, Niedersachsen, Rheinland-Pfalz dhe Saarland një çasje mundësisht e përbashkët e nivelit shtetëror në lidhje me pandeminë e koronavirusit është me domethënie të veçantë për pranimin e vendimeve politike por duke pasur në konsideratë edhe veçantitë regjionale. Në këtë kuptim të një çasje të përbashkët janë dakorduar Kryetarët e Qeverive të Landeve Rheinland-Pfalz, Nordrhein-Westfalen, Niedersachsen si dhe Saarland, që që nga 27 prilli rekomadimi i deritashëm për bartjen e një mbulese të gojës dhe hundës në trafikun publik të jetë i detyrueshëm. Qytetarëve si dhe bizneseve tregtare u jipet kohë e mjaftueshme që nga e hëna për t'u përgaditur për rregullat e reja. Deri atëherë vlen edhe më tutje një lutje urgjente tek qytetarët që të mbulojnë gojën dhe hundën në trafikun publik si dhe dyqane.

Për këtë sqaron Kryetari i Qeverisë Armin Laschet: „Nordrhein-Westfalen i qëndron besnik linjës së tij: Kthimi në një normalitet me përgjegjësi të plotë është i lidhur ngushtë me një mbrojtje dhe ndjekje konsekuente të mbrojtjes së shëndetit. Ne kemi nevojë mundësisht për rregullore të ngjajshme në të gjitha Landet e Gjermanisë. Më e rëndësishmja mbetet: Mbajtja e distancës dhe përmbajtja konsekuente e rregullave higjienike. Sipas pikëpamjes së ekspertëve mbajtja e maskave në pëditëshmëri mund të kontriboj në reduktimin e rrezikut të infektimit. Ne duhet të bëjmë gjithçka, që ndihmon për të gjetur rrugën dhe kthyer në jetën normale. Detyrimi i maskave në disa fusha të jetës zyrtare mund të ndihmoj ndjeshëm.

Nordrhein-Westfaleni do t'í përshtat rregullat e Landit për dyqane me Landet fqinje si Niedersachsen, Hessen dhe Rheinland-Pfalz dhe shumicën e Landeve, në mënyrë që nga e hëna të jetë e mundur nën mbajtjen e masave higjienike, drejtimin e konsumatorëve në hyrje si dhe mënjanimit të pritjeve të gjata të konsumatorëve që të mund të hapen ato dyqane, hapësira shitëse e të cilave mund të reduktohen në një sipërfaqe prej 800 m². Ky vendim në përputhje me pothuaj të gjitha Landet pason edhe në kulturën tonë peshuese, që në njërin anë të mbrojmë së pari shëndetin dhe jetën e qytetarëve dhe në anën tjetër të kemi parasysh gjendjen e bizneseve dhe të vendeve të punës.“

Ky tekst i shtypit mund të gjendet përmes faqes së internetit të Qeverisë së Landit www.land.nrw

[Udhëzime të përgjithshme për mbrojtjen e datave](#)